

---

Konsultimi me publikun

---

**Prodyn shpk**  
**Prodhim I kepuceve**

---

Shtator 2020

---

## 1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

### 1.1 Qellimi i projektit

Eshte e regjistruar ne organet tatimore me NIPT L62120003K Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne Njesia Bashkiake Nr 11 , Rr gjergj balshaj Godina ne 6 . Tirane, Prodyn sh.p.k eshte e pajisur me Lejes Mjedisore Nr 1041 prot, date 06.11.2017është per aktivitetin “Prodhim I kepuceve“ . Shoqeria Prodyn shpk do te aplikoje per ndryshim te kushteve te lejes ekzistuese pasi do kemi ndryshim te siperfaqes(shtim) gjithashtu dhe ndryshim te kapacitetit te prodhimit (shtim).

**Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 Per lejet e mjedisit I ndryshuar :**

#### 7.12.o Prodhim i kepuceve

Konsumi I solventeve eshe me I madh se 5 ton/vit.

### 1.2 Objektivat e aktivitetit

Objektivi I pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi I dyte I ketij aktiviteti eshte do te jete gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 1.3 Vendndodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

Eshte e regjistruar ne organet tatimore me NIPT L62120003K Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne Njesia Bashkiake Nr 11 , Rr gjergj balshaj Godina ne 6 . Tirane, Prodyn sh.p.k eshte e pajisur me Lejes Mjedisore Nr 1041 prot, date 06.11.2017është për aktivitetin “Prodhim I kepuceve“ . Shoqeria Prodyn shpk do te aplikoje per ndryshim te kushteve te lejes ekzistuese pasi do kemi ndryshim te siperfaqes(shtim) gjithashtu dhe ndryshim te kapacitetit te prodhimit (shtim).



### 1.4 Procesi teknologjik

#### Furnizimi ditor i fabrikës Prodyn me lëndë të parë

Prodyn furnizohet me lëndë të parë që i duhen për prodhimin e materialeve nga kompania mëmë EFA Solution sipas urdhërave të punës të marra çdo ditë

Magazina e EFA përgatit fletë daljen me lëndët e para për secilin urdher pune të ndarë me gjithë elementet që nevojiten për prodhimin e artikullit/artikujve në UP respektiv. Lëndët e para dërgohen nga EFA në përputhje me urdhërat ditorë të punës sipas planifikimit të prodhimit për të evituar mbingarkesën me stok, dëmtimet, pamundësinë për manaxhim etj.

- Magazinierët (i lëkurës dhe i aksesorëve sipas ngarkesës) janë përgjegjës për të kontrolluar nëse produktet janë sipas faturës shoqëruese para daljes nga magazina;
- Pasi magazinieri përfundon kontrollin, nënshkruan dokumentin e daljes nga magazina
- Hidhen të dhënat e magazinimit në sistem duke përdorur sistemin e skanimit me barkode.

### Shpërndarja e lëndëve në repartet e punës

Lenda e pare nga magazina EFA dërgohen tek repartet përkatëse të prodhimit në përputhje me programimin e punës ditore të çdo reparti:

- **Shoje/shtorjet dhe ambllazhi.** Magazinierët sipas programit të marr nga Kordinatorja e Prodhimit, përgatit shojet/shtorjet dhe ambllazhin dhe e dërgon tek reparti i Montimit siaps udhëzimit të KP për çdo UP të veçanta.

### Prerja e Lekurës

Prerja e lëkurës është një proces i rëndësishëm për rezultatet totale të kompanisë, prandaj rezultatet e këtij reparti do të maten me eficienten e shfrytëzimit maskimal të lëkurës për të patur sa më pak humbje të lëndës së parë gjatë këtij procesi.

- Pas furnizimit me lende te pare “lekurë/sintetike” Manaxheri i jep detyra ekipit për rregullimin e formave prerëse sipas modelit të kërkuar në urdhërin e punës.
- Manaxheri trainon dhe udhëzon punonjësit për mënyrën si të kontrollojnë lëkurën dhe kujdeset që lëkura të shfrytëzohet në mënyrë sa më eficiente.
- Nëse gjatë këtij procesi evidentohen gabime apo probleme, manaxheri merr masa për eliminimin e problemit dhe korrigjimin e tij në mënyrë që të zvogelohë në maksimum humbjet e mundshme. Bazuar në kot lloj eksperiencash duhet që të sigurohet që të njëjtat gabime/problem të mos ndodhin në të ardhmen.
- **Modelete e reja.** Pas prerjes së lëkurës për palën e parë (prove) duhet të merret konfirmimi nga kontrollori teknik i klientit për cilësinë dhe eficienten e prerjes përpara se të vazhdojë me prerjen në seri.
  - ne rastet kur ka diferenca ne sasine e konsumit të lëkurës duhet të firmoset nga tekniku i klientit formati per “diferenca te konsumit”.
- Prerja bëhet në pale me qëllim që syprinat të jenë të njëjta.
- Pas prerjes, produktet e prera vendosen në ambientete e repartit te Prestaria nga ana e përgjegjesve të repartit të prerjes, në palë me etiketat/kodet përkatëse.
- Manaxheri i Prestarisë mban raportin për sasi të e prera për secilin model në baza ditore (raporti mbahet në magazinën e Prestarisë).

### Papërgatitja

Është përgjegjëse për:

- Kontrollin fizik të lëkurëve të prera.
- Shkajimin, vulsojen dhe budaperta.
- Plotësimin e të gjithë urdherave te punes (nëse ka mangësi ose jashtë standarti), para dërgimit tek linjat e qepjes.
- Dërgojnë Lendene pare tek qepja sipas programit ditor.

## Furnizimi/shtrimi i linjave

Përgjegjësi i tavolinës së hedhjes është përgjegjës për të bërë furnizimin e linjave të prodhimit me lëndë të parë sipas urdhërit të punës.

- Përgjegjësi i tavolinës së hedhjes bën ndarjen e produktit të marrë duke siguruar që gjithë komponentet lënda e parë për një pale këpucë është në një karel.
- Pas këtij hapi fillon procesi i montimit/qpjes/ngjitjes.
- Kontrolli i mëtejshëm i sasive dhe për cilësinë është në përgjegjësinë e drejtuesit të linjës së prodhimit
- Për më shumë shih *FP.8.1-1 "Prezantimi i SOP-së" dhe FP.8.1-2 Efa production disturbance – Personel.*

## Rikontrolli

Pas qpjes kryhet rikontrolli sipas Udhezim per reparatin e rikontrollit.

## Përgatitja e produkteve për qpjen me dorë (Reparti i Shojeve dhe i Qepjes me dorë)

Gjatë këtij procesi përgatiten produktet gjysëm të gatshme për tu dërguar pastaj te reparti i qpjes me dorë.

- Furnizimi me shoje bëhet nga magazinieri i shojeve sipas UP-së.
- Drejtuesi i reparitit merr suprinat e qepura nga reparit i qpjes.
- Bashkohen 10 suprina dhe 10 shoje si dhe aksesorët përkatës dhe dërgohen për qpje me dorë tek nënkontraktori.
- Materialet dërgohen me faturë shoqërimi e cila mbahet në bllokun e faturave në reparit. Fatura e shoqërimit firmoset nga Manaxheri e reparitit dhe përgjegjësi i grupit të qpjes me dorë (nënkontraktori).
- Pas qpjes me dorë Përgjegjsja e grupit të qpjes me dorë/nënkontraktori/ dorëzon tek Manaxherja e raparitit produktet e përfunduara me faturen e hyrjes perkatese.
- Manaxheraj e reparitit i kontorllon produktet dhe i dergon tek reparit i Monitmit sipas urdhrave të Kordinatores së Prodhimit.

## Montimi

Ky është procesi final për prodhimin e produktit të gatshëm përfundimtar.

- Magazinieret/opërori i qpjes me dorë i dergon materialet sipas urdhrave të punës dhe udhëzimeve të KP, për në në reparit e montimit.
- Manaxheri i reparitit të montimit bën shpërndarjen e punës në linjat e montimit
  - Në fund të montimit bëhet ambalazhimi
  - Ambalazhuesit duhet te jenë të kujdesshëm që të mos ngatërrojnë numrin e këpucës me numrin kutisë
  - Të shikojnë ngjyrën e këpucës nëse korrespondon me atë që është në kuti
  - Të kontrollojnë cilësinë
  -

Drejtuesit e linjave të montimit ndjekin të gjithë procesin dhe sigurohen që të mos ketë ndërprerje apo gabime në montim, rezultatet e repartit të montimit maten nëpërmjet:

- Cilësisë së prodhimit,
- Raporti i njësive të prodhuara për orë pune

### **Kontrolli i cilësisë në Prodyn**

#### Drejtuesit e linjave

Drejtuesit e linjave janë përgjegjës që linjat të jenë sa më efikente dhe në të njëjtën kohë duke qënë efektiv në përdorimin e resurseve ne dispozicion. Ata janë përgjegjës:

- Të bëjnë kontrollin e çdo procesi në mënyrë që të sguojnë produkte me cilësi të lartë dhe që punonjësit të jenë sa më efikent.
- Të marrin masa korrektuese në kohë për çdo element i cili nuk shkon sipas standartit dhe parashikimit.
- Në mënyrë të vazhdueshme të bëjnë trajnimin e stafit, duke dhënë udhëzimet ne mënyrën e duhur. Dhe në çdo rast duhet që të sigurohet që punonjësi që ka marrë trajnimin e ka kuptuar dhe di si ta implementojë atë në punën e përditshme.
- Trajnime në punë bëhen në përputhje me pikën me standartet dhe aplikohen për:
  - Punonjësit e rinj.
  - Punonjësit e aktual.
  - Trajnime për çdo produkt/proces të ri.
  - Trajnime për të rforcuar njohuritë e marra.
- Në rastet që evidentojnë gabime apo probleme, drejtuesit duhet që:
  - të gjëjnë shkakun e problemit.
  - të marrin masa korrektuese.
  - të sigurohet që të mos ndodhin në të ardhmen raste të ngjashme.
  - të raportojë tek manaxheri i repartit.

#### Kontrolli i cilësisë në ProDyn

Misioni i ProDyn është të arrijë prodhimin e produkteve me cilësi brenda standarteve të përcaktuara, prandaj kontrolli i cilësisë luan një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e këtij misioni.

Në Prodyn ekzistojnë 3 shkallë të kontrollit të cilësisë:

- Tekniku i palës kontraktuese bën kontrollin e cilësisë së palës test.
- Teknikët dhe drejtuesit e fabrikës bëjnë kontrollin e cilësisë gjatë prodhimit
- Kontrollori i cilësisë pas monitmit kontrollon dhe riparon gabime që mund të ketë nga montimi.

## **2 . IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

### **2.1 Metodologjia**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarise, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi I ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimi
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të nje territori të caktuar.

- Mbrojtja e Përbërësve të mjedisit klasifikohet në:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne peizazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Shkarkimet e lengeta
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi I tyre
- Ndikime socio-ekonomike
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	masat zbutese qe duhet te ndermerren
<b>Pejsazhi</b>	Ndryshim i pejisazhit te zones	Mbjellje pemesh ne perimete te gjithe siperfaqes per minimizimin e pamjes se aktivitetit te Prodyn shpk nga banesat perreth.
<b>Toke</b>	Ndikim ne ndotje te tokes	Kontroll I vazhdueshem I venddepozitimit te mbetjeve. Kontroll te vazhdueshem per pastertin dhe nese ka njolla hidrokarburesh te shesheve te jashteme te aktivitetit te ndermerren masat e nevojshme.
<b>Uje</b>	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Kontroll te vazhdueshem per pastertin dhe nese ka njolla hidrokarburesh te shesheve te jashteme te aktivitetit te ndermerren masat e nevojshme.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Kontroll I vazhdueshem I venddepozitimit te mbetjeve. Kontroll te vazhdueshem per pastertin dhe nese ka njolla hidrokarburesh te shesheve te jashteme te aktivitetit te ndermerren masat e nevojshme.
<b>Ajer</b>	Emisione gazesh dhe aromash.	Kontroll periodik te shkarkimeve nga mjetet e transportit.
	Aromat	Te merren masa per minimizimin dhe/ose mbulimin e aromave te pakendshme ne mjedisin perreth fabrikes.
	Zhurme, vibrime	Te kryhen kontrole peridike te gjendjes teknike te mjeteve te transportit te mbahet nen kontroll dhe te respektohen normat e udhezimit nr. 8 date 27.11.2007. te kryhet organizmi i pershtatshem ne menyre qe te shmangen levizje e ne orare te papershtatshme.



<b>Mjedisi biologjik</b>	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i fabrikes.	
<b>Mjedisi human</b>	Shqetesim te banoreve te zones	Te ndermerren masat e nevojshme per zhurmat, shkarkimet ne atmosfere dhe sharkimet e lengeta.	
<b>Ndikimet te tjera te projektit</b>	Ndikimet ne trafik	Te organizohet levizja e mjeteve per te shmangur oraret e pikut te levizjes se mjeteve duke qene se eshte zone me intensitet te larte banimi.	
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Gjeneratori do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.	
	Konsumi i ujit	Uji qe perdoret merret nga ujesjellesi.	
	Siguria dhe ndikimet ne shendet		Te respektohen kushtet e sigurise ne pune. Punonjesit duhet perdorin ne menyre te detyrueshme mjetet e mbrojtjes personale.
			Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik.
Ndikime social-ekonomike		Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsise se zones nga punesimi.	

## MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate zhvillimit te aktivitetit te ndertimit nga ana e shoqerise

Prodyn shpk duhet qe shoqeria te marre masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

### Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
<b>Parandalim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Siperfaqet e subjektit te jene te betonizuara dhe te pajisura me kanale kulluese.               <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kontroll periodik i gjendjes teknike I sistemit teknologjik dhe mjeteve te transportit</li> </ul> </li> <li>- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per te garantuar nje produkt perfundimtare sipas kerkesave te klienteve dhe me kushte te larta higjieno-sanitare</li> <li>-Sigurimi i kontenitoreve qe do te perdoren per mbetjet deri ne kohen kur te transportohen ne kompanite ricikluese.</li> <li>-Pajisja e punonjesve me mjetet e pershtatshme mbrojtese si doreza, maska etj.</li> <li>-Vendosja e tabelave sinjalizuese ne raste emergjente te zjarrit, pikat e grumbullimit etj.</li> <li>- Vendosja e daljeve te emergjences per kapanonin ku qendrojne punonjesit</li> </ul>
<b>Kontroll</b>	<p>Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.</p> <p>Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve</p> <p>Levizje e ngadalte e automjeteve ne fabrike dhe jashte saj.</p> <p>Larje e shpeshte e makinerive dhe automjeteve.</p>
<b>Nderhyrje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.</li> <li>- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara nga procesit teknologjik.</li> <li>- Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale</li> <li>- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)               <ul style="list-style-type: none"> <li>– Dezinfektimi i ambienteve te punes</li> </ul> </li> </ul>
<b>Administrim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.</li> <li>- Ndarje e pergjegjesisë dhe adresim i sakte per ceshtje te sigurise</li> </ul>

Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Clirimi i gazeve te demshem per mjedisin gjate perdorimit e gjeneratorit	Perdorimi i fabrikes ne oret me energji elektrike nga rrjeti. Kolaudimi i gjeneratorit dhe perdorim i lendeve djegese cilesore.
2	Ndotje te ujrave siperfaqesore si pasoje e derdhjes se ujrave qe gjenerohen nga aktiviteti	Te respektohen normat e percaktuara ne VKM 177 date 31.03.2005 Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisese ujore pritese.
4	Ndotja e tokes dhe ujrave nentokesore	Ne raste aksidentesh te merren te gjitha masat per rikuperimin e ndotjes.
5	Manaxhimi i mbetjeve	Lidhja e kontratave me subjektet e licensuar me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti.
6	Siguria e punonjesve	Subjekti duhet te realizoje dhe simulime me stafin per te perballuar situata emergjente. Te vendosen sinjalistika e nevojshme dhe dyert e emergjences dhe te kryhet trajnimi perkates i punonjesve. Punonjesit e fabrikes te pajisen me uniforma pune dhe te gjitha mjetet mbrojtese si doreza dhe maska.
7	Rritja e trafikut te mjeteve te renda ne trafikun tokesor, por ne nivele te uleta	Shoqeria duhet te kete ne konsiderate: <ul style="list-style-type: none"> <li>- te perdori infrastruktures ekzistuese,</li> <li>- perdorimi i mjeteve te kolauduara,</li> <li>- qarkullimi ne orare me trafik me pak te renduar,</li> <li>- reduktimi i renies se borieve ne zona te banuara,</li> <li>- organizimi i hyrjes dhe daljes automjeteve nga subjektietj.</li> </ul>
8	Zhurma nga veprimataria	Procesi teknologjik nuk shoqerohet me nivele te larta te zhurmes. Ne pikat ku niveli i zhurmes eshte me i larte dhe koha e ekspozimit me e gjate te merren masa per punonjesit qe jane te ekspozuar duke perdorur mjete mbrojtese.

### Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura dhe gaze te shkarkuara gjate fazes se transportit	Mjetet e transportit duhet te levizin me shpejtesi te ulet gjate transportit si dhe mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht. Nevojitet te kontrollohet vazhdimisht gjendja e tyre teknike, dhe te kryen serviset periodike te nderrimit te filtrave. Rruget e brendshme duhet te jene te shtruara me asfalt.
2	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

### Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabeles do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorimi i shkarkimeve ne ajer nga aktiviteti	Periodike (Cdo 6 muaj)	LNP mes,LNP max, PM10 4 pika O2, CO,SO2,H2S,CH4, VOC 3pika
2	Monitorimi i zhurmes se shkaktuar	Periodik (raportim cdo 6 muaj)	4 pika te ndryshme Zhurma (dbA) nga aktiviteti.
3	Monitorim i shkarkimeve te lengeta	Periodik (raportim cdo 6 muaj)	1 moster

\* Cdo parameter dhe ndikim qe mund te identifikohet nga aktiviteti mund te shtohet si parameter per tu monitoruar